

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Flakët shkrumbuan dhjetëra hektarë pyje dhe kullota, vetëm 23 bashki kanë buxhet kundër zjarrit
ADRESA	https://zoom.al/flaket-shkrumbuan-dhjetera-hektare-pyje-dhe-kullota-vetem-23-bashki-kane-buxhet-kunder-zjarrit/
BURIMI	zoom.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 07:02:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 06:48:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	30405a0c7b8fdff5f808d429d2ef9aec3f15a6932e159b697c7173f6b5871be8
TEKSTI	6953a3818c65b79ae49d2de94270880c8507f1f31843ccfe99c9ef865613003d
PAMJA	dc4596948c82751ae5e5980bd6e0d72f7d0d259281991bad14032c84a9c283bd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	080bc0c45a448c0a8db03d00eca00eef7dbbe5a24a7195b1e404a8ce79d57866
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a4c534b660452ad45d6abef4c18cc65e8511af8536347f8687e7f65a9e7ea795
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmQaJPJvsr8Bbptarmn54TzLmD2ect51RUbe7VvoijLdUC



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/080bc0c45a448c0a8db03d00eca00eef7dbbe5a24a7195b1e404a8ce79d57866>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



Direct tv
Direct Kërko
Direct Radio
Radio

- Aktualitet
- In Zoom
- Politikë
- Ekonomi
- Kosova
- Rajoni
- Bota
- Stil
- Tech

Kërkoni në zoom.al

Lajmet e fundit

Aeroplani i Amazon del jashtë piste gjatë uljes në aeroportin e Miami, raportohet për 5 viktimat

Aeroplani i Amazon del jashtë piste gjatë uljes në aeroportin e Miami, raportohet për 5 viktimat

Mrekulli në Nepal, 64-vjeçarja gjendet gjallë pas 11 ditësh e bllokuar në rrënoja

Mrekulli në Nepal, 64-vjeçarja gjendet gjallë pas 11 ditësh e bllokuar në rrënoja

New York Post: Alarmi për lodrat e njohura "Squishy". Rrezik për lëndime serioze dhe vdekje të fëmijët

New York Post: Alarmi për lodrat e njohura "Squishy". Rrezik për lëndime serioze dhe vdekje të fëmijët

Skandal në SHBA: gazetari i njohur nën akuzë për pedofili. Dalin mesazhet shqetësuese

Skandal në SHBA: gazetari i njohur nën akuzë për pedofili. Dalin mesazhet shqetësuese

- Politikë
- Aktualitet
- Sport
- LifeStyle
- Teknologji

Radio One
Radio One

- Aktualitet
- In Zoom
- Troç
- Politikë
- Ekonomi
- Ide & Blog
- Kosova
- Rajoni
- Bota
- Sport
- Art & Kulturë
- Stil
- Kinema & Netflix
- Tech

Rrjetet Sociale

- Facebook
- Instagram
- X
- Youtube

Aplikacion

- zoom Business
- zoom

Aktualitet

Flakët shkrumbuan dhjetëra hektarë pyje dhe kullota, vetëm 23 bashki kanë buxhet kundër zjarrit

07/09/2026 / 08:48

- facebook
- messenger
- Whatsapp
- Twitter

Flakët shkrumbuan dhjetëra hektarë pyje dhe kullota, vetëm 23 bashki kanë buxhet kundër zjarrit

Teksa zjarret këtë verë kanë shkrumbuar dhjetëra hektarë pyje dhe kullota në të gjithë vendin duke krijuar dëme që llogariten në miliarda lekë, bashkitë dhe pushteti vendor nuk arriti të investojë dhe të përdorë edhe ato pak fonde që kanë në dispozicion.

Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave tregojnë se vetëm 23 bashki kanë përllogaritur në buxhetet e tyre fonde për mbrojtjen nga zjarri me një vlerë totale rreth 729.6 milionë lekë për këtë vit.

Teksa shpenzimet faktike deri në fund të qershorit ishin vetëm 75.7 milionë lekë me një nivel realizimi prej vetëm 10.4% të fondeve të programuara.

Nga 23 bashki që kishin të parashikuara investime në programin e mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtjes civile, vetëm 11 kishin regjistruar shpenzime deri në qershor, ndërsa 12 të tjera nuk kishin realizuar ende asnjë pagesë, sipas të dhënave zyrtare.

Diferenca më e madhe mes fondeve të parashikuara dhe realizimit vihet re në Bashkinë e Tiranës. Kryeqyteti ka rreth 356.8 milionë lekë të programuara, ose pothuajse gjysmën e të gjithë fondit të 23 bashkive të marra së bashku.

Por deri në fund të qershorit, shpenzimet faktike të Tiranës ishin vetëm 164.9 mijë lekë, duke e çuar realizimin në rreth 0.05% të buxhetit total.

Edhe Bashkia e Durrësit, e dyta ndër bashkitë e mëdha për fondet e programuara në këtë sektor, kishte rreth 104 milionë lekë buxhet, por deri në qershor nuk rezultonte të kishte realizuar asnjë shpenzim.

Vetëm Tirana dhe Durrësi përqendrojnë mbi 63% të të gjitha fondeve të programuara nga 23 bashkitë, ndërsa së bashku deri në qershor kishin shpenzuar vetëm rreth 165 mijë lekë. Kjo ndikon ndjeshëm në nivelin e ulët të realizimit në shkallë vendi.

Në kahun tjetër, Himara kryeson për vlerën e shpenzimeve faktike. Bashkia kishte realizuar 46.8 milionë lekë, nga 143.8 milionë lekë të programuara, ose rreth 32.5% të fondit. Pothuajse e gjithë shuma e realizuar nga Himara lidhet me blerjen e një automjeti zjarrfikës, me vlerë 46.8 milionë lekë, projekt që rezultoi i paguar në masën 100%.

Pas Himarës renditet Pusteci, me rreth 10.8 milionë lekë shpenzime nga 18.9 milionë lekë të parashikuara. Pjesa kryesore lidhet me blerjen e një mjeti për shërbimin e MZSH-së.

Kukësi kishte një nga nivelet më të larta të realizimit. Nga 8.46 milionë lekë të programuara, ishin shpenzuar rreth 8.44 milionë lekë, ose 99.7%. Rreth 7 milionë lekë janë përdorur për blerjen e një automjeti zjarrfikës.

Edhe Librazhdi kishte realizuar praktikisht të gjithë fondin prej rreth 4.55 milionë lekësh, ndonëse pjesa më e madhe e tij lidhet me ndërhyrje të mbrojtjes civile dhe jo drejtpërdrejt me pajisje zjarrfikëse.

Në total, vetëm Himara, Pusteci dhe Kukësi përbëjnë rreth 87% të të gjitha shpenzimeve faktike të evidentuara deri në qershor për 23 bashkitë.

Ndërkohë, përveç Durrësit, nuk rezultoni ende shpenzime në bashki si Kavaja, Kruja, Vlora, Bulqiza, Malësia e Madhe, Gramshi, Puka, Përrenjasi, Këlcyra dhe Dropulli, megjithëse në buxhet kishin fonde të parashikuara për këtë program.

Të dhënat i referohen situatës deri në fund të qershorit 2026, ndaj ato tregojnë ecurinë e realizimit në gjysmën e parë të vitit dhe jo rezultatin përfundimtar të shpenzimeve vjetore./ Monitor

Postime të lidhura



["Po na digjet shtëpia!" - Zjarri del jashtë kontrollit në Fier, flakët avancojnë drejt fshatit](#)



[Katër vatra zjarri në pyllin e Semanit, flakët përhapen me shpejtësi](#)



[Përshkallëzohen flakët në Levan, asfiksohen 3 persona](#)



[Situata alarmante me zjarrin në Fier/ Shefi i Mbrojtjes Civile: Janë evakuuar disa familje, ndërhyrje nga toka dhe ajri](#)



[Situatë apokaliptike në Himarë/ Digjen banesa, lëshohet urdhër evakuimi \(VIDEO\)](#)



[Zjarret apokaliptike, si paraqitet situata në Himarë! Ndërhyrje nga toka dhe ajri për shuarjen e flakëve](#)



[Zjarret në disa zona të vendit, FA në terren për shuarjen e flakëve, evakuohen 10 familje në Fier](#)

Postimi i fundit

[Makina përplaslet me kamionin në autostradën Durrës-Tiranë, vdes 45-vjeçari! Aksidentohen edhe 3 mjete të tjera](#)

Lajme

- [Makina përplaslet me kamionin në autostradën Durrës-Tiranë, vdes 45-vjeçari! Aksidentohen edhe 3 mjete të tjera](#)
Makina përplaslet me kamionin në autostradën Durrës-Tiranë, vdes 45-vjeçari! Aksidentohen edhe 3 mjete të tjera
- [Flakët shkrumbuan dhjetëra hektarë pyje dhe kullota, vetëm 23 bashki kanë buxhet kundër zjarrit](#)
- [Aeroplani i Amazon del jashtë piste gjatë uljes në aeroportin e Miami, raportohet për 5 viktime](#)
- [Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndodh me monedhat e tjera](#)
- [Aksident me vdekje pranë rrethrotullimit të Levanit, vdes 55-vjeçari! Makinat bëhen copash \(VIDEO\)](#)

Nga e njëjta kategori

[Makina përplaslet me kamionin në autostradën Durrës-Tiranë, vdes 45-vjeçari! Aksidentohen edhe 3 mjete të tjera](#)

[Makina përplaslet me kamionin në autostradën Durrës-Tiranë, vdes 45-vjeçari! Aksidentohen edhe 3 mjete të tjera](#)

[Aksident me vdekje pranë rrethrotullimit të Levanit, vdes 55-vjeçari! Makinat bëhen copash \(VIDEO\)](#)

[Aksident me vdekje pranë rrethrotullimit të Levanit, vdes 55-vjeçari! Makinat bëhen copash \(VIDEO\)](#)

[Temperatura deri në 38 gradë, moti për ditën e sotme](#)

[Temperatura deri në 38 gradë, moti për ditën e sotme](#)

[Berisha flet nga SHBA: Ata që më ndaluan, sot janë non-grata në vendin e tyre](#)

[Berisha flet nga SHBA: Ata që më ndaluan, sot janë non-grata në vendin e tyre](#)

[Arkiva](#)

[2020](#)

[2021](#)

[2022](#)

[2023](#)

[2024](#)

[2025](#)



Lajme, investigime, analiza e dosier. Gjithçka e trajtuar me profesionalizëm!

[Facebook](#)

[Twitter](#)

Apilkacion mobile

[Apple](#)

[Android](#)

[Kontakt](#)

© Copyright 2020-2026 Zoom.al

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.